



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.314/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj-kryesues, Ramush Bardiqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Valon Sopjani, kandidat për anëtar në kuvend komunal të Fushë Kosovës nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesave të votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 24.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e parashtruara nga Valon Sopjani, kandidat për anëtar në kuvend komunal të Fushë Kosovës nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesave të votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.314/2025 të kandidatit Valon Sopjani nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), ku pretendon se bazuar në deklaratat e vëllait të tij, djemve të xhaxhait dhe shokut të tij ka marrë se paku 4 vota më postë, ndërsa nga publikimi i rezultateve ka dal vetëm 1 votë. Si prova, parashtruesi i ankesave ka bashkangjitur email adresat e disa deshmitarëve në të cilat konfirmohet së të njëjtit e kanë votuar

Në përgjigjen në ankesë të datës 23.10.2025, Komisioni Qendror Zgjedhor theksojnë se pas shqyrtimit të pretendimeve të palës ankuese jep këto sqarime lidhur me votat e votimit jashtë vendit, ju njoftojmë se me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarte të Veprimit për Votimin jashtë Kosovës dhe vlerësimin e pakove me fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedurë shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr.17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara më postë, sipas të cilës: *17.Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë*

hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr.14/2024 për QNR,parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht në par.9 të nenit 20 parashihet se: “Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.” Procesi i numërimit të votave në QNR, është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore nr.14/2024,QNR ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahas fletëvotimeve,në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Gjithashtu, ju njoftojmë se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e Valon Sopjani, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë se ka mungesë të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga familjarët e tij, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë bindëse dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe me prova konkrete.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështetet në deklarinimin e disa familjareve – votuesve, këto pretendime janë të provuara dhe bindëse, po ashtu sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë votës, prandaj edhe për këtë arsye nuk e mori parasysh këtë pretendim.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesë,

parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.314/2025 datë 24.10.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.